



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	10.07.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Qershor

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.06.2025 deri me 30.06.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit qershor, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka realizuar një sërë aktivitesh të rëndësishme që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe përmirësimin e kushteve të punës për fermerët në territorin e Komunës së Lipjanit. Aktivitetet në vijim pasqyrojnë përkushtimin tonë për ofrimin e shërbimeve efikase dhe mbështetëse për komunitetin bujqësor.

Janë përmbyllur të gjitha procedurat e prokurimit për furnizimin me motokultivatorë, të cilët do të shpërndahen shumë shpejt tek përfituesit e listës pritëse. Ky projekt synon të lehtësojë punët bujqësore për fermerët e vegjël, duke rritur efikasitetin dhe produktivitetin në kultivimin e tokës.

Është drejt finalizimit procesi për ndarjen e serave me sipërfaqe 50 m² për fermerët përfitues të listës pritëse. Shpërndarja e tyre do të bëhet brenda një kohe të shkurtër, me qëllim që të ndihmohen fermerët në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, sidomos në perimkultur.

Gjatë këtij muaji është realizuar zhavorrimi i një pjese të rrugëve bujqësore në fshatin Bukovic, duke mundësuar një qasje më të lehtë për fermerët drejt pronave të tyre. Kjo ndërhyrje synon të ndihmojë në zhvillimin bujqësor në zonat rurale.

Komisioni profesional ka përfunduar shqyrtimin dhe përgatitjen e të gjitha lëndëve të fermerëve aplikues në sektorin e Blegtoris. Është hartuar dhe dorëzuar raporti final për pagesat e subvencioneve.

Është duke vazhduar aktivitetet për menaxhimin dhe trajtimin e qenve endacakë, si në lagjet e qytetit ashtu edhe në lagjet nëpër fshatra të Komunes së Lipjant. Këto veprime janë ndërmarrë në bashkëpunim me operatorë të kontraktuar dhe me qëllim të garantimit të sigurisë publike dhe mbrojtjes së kafshëve.

Ekipe tona janë të angazhuara në terren për të bërë inspektime dhe vlerësime të drejtpërdrejta të dëmeve që janë raportuar nga fermerët si pasojë e kushteve klimatike apo faktorëve tjerë të jashtëm. Ky proces ka për qëllim të sigurojë reagim të shpejtë dhe adresim të drejtë të kërkesave të fermerëve.

Në fillimit të sezonit të korrje-shirjeve, i cili pritet të nisë gjatë muajit korrik, janë intensifikuar vizitat në terren për të inspektuar gjendjen teknike të kombajnave dhe për të ndihmuar në koordinimin e punëve të nevojshme për një sezon sa më të suksesshëm dhe pa vonesa.

Drejtoria për Bujqësi mbetet e përkushtuar në përkrahjen aktive të fermerëve dhe në realizimin e projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës dhe punës së fermerëve lipjanas.